



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Ftesë për media
27 prill 2021

RrGK prezanton raportin “Nga Ligjet në Vepra: Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë”

Nesër, më 28 Prill 2021 nga ora 14:00 deri në 15:45, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) publikon raportin hulumtues [Nga Ligjet në Vepra: Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë](#), realizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) me mbështetje financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Kjo ngjarje do të mbahet në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore në Kosovë në Zyrën e Kryeministrit.

Do të diskutojmë me akterët kryesorë fizibilitetin e zbatimit të rekomandimeve, veçanërisht për ndryshimet ligjore dhe institucionale, në kontekstin e reformave të vazhdueshme në kornizën ligjore të Kosovës për ta harmonizuar atë me Konventën e Stambollit, veçanërisht projektligjet për Familjen dhe Shërbimet Sociale dhe Mbrojtjen nga Dhuna me Bazë Gjinore; Procedurat Standarde të Operimit; dhe Strategjinë e re dhe Planin e ri të Veprimit për Dhunën me Bazë Gjinore në Kosovë. Gjithashtu do të paraqesë gjetjet dhe rekomandimet kryesore për institucionet dhe aktorët përkatës.

Folëset do të përfshijnë, Zëvendës Ministren e Drejtësisë dhe Koordinatorin Nacionale kundër Dhunës me Bazë Gjinore, Nita Shala, Kryeshefen Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore, znj. Edi Gusia, Këshilltaren dhe Udhëheqësen e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim të Kosovës, Sandra Horina, si dhe Kryetaren e Bordit të RrGK-së, Ariana Qosaj-Mustafa e cila do të moderojë diskutimin, ndërsa gjetjet e raportit do të prezantohen nga Nicole Farnsworth, Bashkëautore, Drejtore Programi / Hulumtuese Kryesore në RrGK dhe Erza Kurti, Koordinator e Projektit në Programin Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, RrGK.

Kjo ngjarje është e hapur për publikun, për të qenë pjesë e saj klikoni këtu: <https://zoom.us/j/96550634005?pwd=S3BpQmZ0STZWMTYzejR5QjNMeE0yUT09>

Ngjarjen do të mund ta ndiqni edhe live përmes faqes sonë të [Facebook-ut](#).

Për çdo çështje teknike gjatë kësaj ngjarje, ju lutem kontaktoni: Rudina Voca përmes e-mail adresës (rudina@womensnetwork.org), telefonit, ose Viber (+383 49 538 950), në rast se ju nevojitet asistencë për t'u lidhur. **Bashkëngjitur mund ta gjeni agjendën e kësaj ngjarjeje.**